



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI TEKNIK

Nr. 129 Prot.

Tiranë, më datë 27.05.2024

VENDIM
Nr. 5, datë 27.05.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, si dhe në Vendimin e KKTKM-së, Nr. 27 datë 19.02.2020 “Për miratimin e llojeve të ndërhyrjeve me karakter mirëmbajtës të pasurive kulturore, sipas listës bashkëlidhur”, pas shqyrtimit të projektit, në mbledhjen e datës 27.05.2024, Këshilli Teknik:

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimit “Biletaria (provizore) në Amfiteatrin e Durrësit”, Bashkia Durrës, me aplikues dhe zhvillues **Qendra Muzeore Durrës**;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETAR I KT
Klesta CIRICI